



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 14.10.2020, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Time Kadrijaj, Fitore Pacolli, Branislav Nikoliq, Fatmire Kollçaku, Gazmend Gjyshinca, Ariana Musliu-Shoshi dhe Fidan Brina-Jilta.

Munguan: Kujtim Shala, Arben Gashi dhe Enver Hoxhaj.

Në takim morën pjesë: **Ermina Lekaj-Përlaskaj**, deputete në Parlamentin e Republikës së Kroacisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Flakona Hasani, GP-LDK; Arta Berisha, GP-LVV; Arbëresha Asllani, GP-AAK.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Time Kadrijaj, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

Takim me Ermina Lekaj-Përlaskaj, deputete në Parlamentin e Republikës së Kroacisë.

Time Kadrijaj, fillimisht i dëshiroi mirëseardhje në Kosovë, znj. Lekaj Përlaskaj dhe e përgëzoi për mandatin e tretë të saj si deputete në Parlamentin e Kroacisë, që përfaqëson komunitet atje. Falënderoi shtetin e Kroacisë për gjithë përkrahjen që i ka dhënë Kosovës para, gjatë dhe pas luftës, i cili bashkëpunim shpreson se do të vazhdojë. Po ashtu, tha se Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë zhvillon bashkëpunimin parlamentar dhe diplomacinë parlamentare me vendet e tjera dhe këtë takim e konsideron urë lidhëse në mes të dy vendeve. Më tej, tha se përvoja e Kroacisë na është e nevojshme, që ne të përfitojmë dhe të mos kalojmë nëpër sfidat të cilat ka kaluar Kroacia.

Ermina Lekaj-Përlaskaj, njoftoi se sërish në këto zgjedhje është zgjedhur deputete dhe si çështje kryesore ka që të promovojë komunitetin shqiptar dhe të mbrojë interesat dhe të jetë urë lidhëse në mes të Kosovës e Kroacisë. Gjithashtu, njoftoi se gjatë vitit të kaluar, me deputetët e Kuvendit të Kosovës, kanë arritur t'i kenë dy takime të grupit të miqësisë, që më parë nuk i kanë pasur. Theksoi se Kroacia është e gatshme që të përkrahë Kosovën, por Kosova duhet shprehur kërkesat e saj.

Time Kadrijaj njoftoi se ka biseduar me ambasadorin tonë në Kroaci për aranzhimin e një vizite nga delegacioni i komisionit në Kroaci.

Fitore Pacolli- Dalipi, tha se është kënaqësi për ne që kemi deputetë në Kroaci, që përfaqësojnë shqiptarët dhe zërin e Kosovës atje, e po ashtu uroi që në të ardhmen të kemi më shumë deputetë në vendet e Evropës, sepse është në interes të Kosovës. Kroacia është pjesë e BE-së dhe ne duhet të na ndihmojë të ecim përpara, sepse kemi ngecje në rrugën drejt BE-së. Më tej, tha se Raporti i Progresit, kësaj radhe, na ka vendosur në një pozitë jo të mirë, në 34 sektorë, pa asnjë progres. Është e nevojshme, një punë e madhe për bindjen e shteteve të BE-së për liberalizimin e vizave për Kosovën e po ashtu na nevojitet ndihma e Kroacisë, që të na vërë në kontakt me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën dhe për vënien e marrëdhënieve me shtetet që na kanë njohur, që të vëmë kontaktet, tha znj. Pacolli.

Ariana Musliu- Shoshi falënderoi deputeten Ermina Lekaj-Përlaskaj, për vizitën dhe njëkohësisht falënderoi Kroacinë për ndihmën që i ka dhënë Kosovës.

Fidan Brina- Jilta falënderoi deputeten Lekaj-Përlaskaj për vizitën dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim në aspektin e të drejtave të komuniteteve pakicë.

Fatmire Mulhaxha- Kollçaku përgëzoi deputeten Lekaj-Përlaskaj për mandatin e tretë, si deputete në një shtet të dytë. Në mes tjerash, njoftoi deputeten Përlaskaj për sfidat që ka Kosova e si sfidë e parë, tha se është liberalizimi i vizave. Pyeti deputeten Përlaskaj: Cilat janë sfidat e shqiptarëve atje, sa janë të integruar, sa është e kënaqur me arritjet, synimet, si dhe për sfidat në ballafaqim me Covid- 19, të cilat i ka Kroacia?

Gazmend Gjyshinca i dëshiroi mirëseardhje deputetes Ermina Lekaj- Përlaskaj. Vuri në pah se Republika e Kroacisë, mes viteve 2008-2012, ka pasur 1.2 milion euro investime në Kosovë, që ka të bëjë me një bilanc shkëmbimi ekonomik e tregtar jashtëzakonisht të vogël, përkundrejt potencialit, i cili është shumë më shumë. Ai theksoi se Republika e Kroacisë ka 23 forca të armatosura në KFOR, merr pjesë në EULEX, kemi 8 marrëveshje bilaterale të nënshkruara me Kroacinë, që e bëjnë atë njërin prej shteteve brenda BE-së, me të cilin kemi më së shumti marrëveshje të nënshkruara. Në vazhdim, i bëri pyetje deputetes Lekaj Përlaskaj: Cilat janë 3 fushat kryesore për të cilat mendoni se do të ishte e duhur të përkushtoheshim në marrëdhëniet tona, në mënyrë që të shkojë cilësia edhe më në nivel në mes të Kroacisë e Kosovës? Cili është qëndrimi i Kroacisë, për momentin, ndaj problemit jashtëzakonisht kompleks, siç është Bosnja e Hercegovina dhe cili është qëndrimi dhe veprimet konkrete të Kroacisë, lidhur me ndikimin rus e kinez në Ballkan?

Ermina Lekaj-Përlaskaj, tha se mesazhet e deputetëve do t'ua përcjellë shoqatave shqiptare në Kroaci, të cilat pak a shumë janë të angazhuara në binjakëzimin e qyteteve kroate me ato të Shqipërisë, por edhe të Kosovës. Sa i përket bashkëpunimit në mes të deputetëve, njoftoi se në Parlamentin e Kroacisë kanë një deputet çek, i cili i përfaqëson interesat e komunitetit çek e sllovak në Kroaci dhe ai ka bashkëpunim të ngushtë me Çekinë dhe Sllovakinë dhe do të marrë iniciativë të jetë pjesë e delegacionit të tij në vizita në këto vende, por edhe përmes ambasadës së tyre, do të iniciojë ndërmarrjen e takimeve të përbashkëta të deputetëve. Po ashtu, tha se KPJ i Parlamentit të Kroacisë, është i gatshëm për bashkëpunim dhe ta ndihmojë KPJD të Kuvendit të Kosovës. Si fusha kryesore për bashkëpunim me Kroacinë, tha se propozon të jetë diplomacia. Është i nevojshëm kontakti me deputetin kroat Shtif, i cili është edhe anëtarë i KPJ, dhe sinqerisht, i interesuar për bashkëpunim në

mes të Kosovës dhe Kroacisë. Në mes të Kosovës e Kroacisë mungon bashkëpunimi ekonomik, kryesisht për shkak se investitorët nga Kroacia ndjejnë pasiguri për të investuar në Kosovë. Ajo tha se do të ishte mirë që të hapet sërish Oda Ekonomike Kroate, hap i cili ishte ndërmarrë në bashkëpunim me ambasadorin, por për shkak të pandemisë dhe situatës politike, ka ngecur. Deputetja Lekaj-Përlaskaj njoftoi se Kroacia nuk ka raporte shumë të ngushta në aspektin politik me Bosnjë Hercegovinën nga se mendojnë se kroatët si një etnitet në Bosnjë nuk janë aty ku duhet të jenë, duke pasur parasysh edhe zgjedhjet e fundit që i kanë pasur, ku përfaqësuesi kroat nuk është zgjedhur nga populli kroat, por nga politika e Bosnjë e Hercegovinës. Sa i përket përqendrimit të rusëve dhe kinezëve në Kroaci, tha se nuk iu jepet mundësia bizneseve ruse e kineze që të futen në Kroaci. Ajo njoftoi se komuniteti shqiptar në Kroaci ka dhënë një kontribut shumë të madh, si gjatë luftës, por edhe tani kontribuon në zhvillimin e vendit. Po ashtu, tha se komunitetin tonë është e rëndësishme që përmes shoqatave të arrijë të ruajë kulturën, traditën e gjuhën tonë. Deputetja Lekaj- Përlaskaj njoftoi edhe për angazhimet për hapjen e katedrës së gjuhës shqipe në Kroaci, për të cilën iniciativë, tha se duhet të merren ministritë e të dy vendeve e po ashtu edhe për angazhimin për punësimin e tre të rinjve tanë në Kroaci, në institucione të vendit.

Time Kadrijaj falënderoi deputeten Lekaj Përlaskaj për vizitën dhe bashkëpunimin me Kuvendin e Kosovës dhe i dhuroi një dhuratë simbolike.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Time Kadrijaj